



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Nr. I faq. 03
 Broj stranica 03
 Nr. pages 03

Nr. Prot. 01-849/15
 Br. Prot. 01-849/15
 Prot No. 01-849/15
 Data 24-03-2015
 Datum 24-03-2015
 Date 24-03-2015

PRISHTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	23/03/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Besar MAQEDONCI Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit - Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
CC:	z. Albert AVDIU Drejtore - Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë”

I nderuar z. MAQEDONCI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë” me numër prokurimi: 33300/15/002/511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik: “Ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë” me numër prokurimi: 33300/15/002/511, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

A r s y e t i m

Për rastin me nr. protokoli: DPKPP 03-03-584/15

Autoriteti Kontraktues, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, bazuar në nevojën për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ka paraparë aktivitet prokurimi me Procedurë të Hapur. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. është shpallur më datë: 24/02/2015.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës gjatë përpilimit të dosjes së tenderit të lartë cekur nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me ligjin e Prokurimit Publik.

Në "Njoftim për Kontratë" për tenderin "Ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjakovë", Autoriteti Kontraktues tek pika III.2.3, Kapaciteti Ekonomik Financiar është kërkuar që: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor i operatorit ekonomik për tre vitet e fundit 2012-2013-2014 është jo më pak se 5.000.000,00 €" Autoriteti Kontraktues me kërkesën për qarkullim prej 5.000.000,00 € ka kaluar kufizimin sipas UA-02/2014. Udhëzimi përkufizon se Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj qarkullim financiar për tre vitet e fundit shumë të caktuar e cila nuk duhet të kaloj dy herë vlerën e parashikuar të Projektit.

Në "Njoftim për Kontratë" pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe Profesional, nënpika 3 kërkohet: "Operatori ekonomik duhet të ofrojë së paku tre referenca për përfundim të kënaqshëm të punëve ndërtimore të natyre së njëjtë" sipas Udhëzuesit Operativ të Prokurimit publik, tabela Kriteret e Përzgjedhjes, pika 3 Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, nënpika b. Vlera minimale referencë në lidhje me shërbimet në 3 vitet e fundit, duhet të kërkohet: Një listë që specifikon secilin nga projektet punuese të OE dhe aktiviteteve të ndërtimit të kryera nga OE në 3 vitet e fundit të përcjellë me certifikatë të ekzekutimit të mirë që tregojnë vlerën, datën dhe llojin dhe vendin e projektit punues dhe/ose aktiviteteve të ndërtimit.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në përpilimin e Dosjes dhe dokumentacionit përcjellës për këtë aktivitet nuk ka bërë harmonizimin material në përmbajtjen e dokumenteve përkatës. Në Njoftim për Kontratë në Gjuhën Shqipe, në përshkrimin e afateve kohore për aktivitetin e prokurimit, pika IV.3.3 Afati i fundit për pranim të tenderëve është data 06/04/2015, ndërsa në pikën IV.3.7 Takimi për hapjen e tenderit është data 02/04/2015. Hapja është caktuar para dorëzimit të tenderit, deri sa në Dosjen e Tenderit data është në rregull. Data e hapjes së tenderit 06/04/2015, është ditë feste në Kosovë dhe në këtë datë hapja nuk mund të realizohet.

Autoriteti Kontraktues në Njoftim për Kontratë në gjuhën serbe dhe angleze ka kërkuar 30 punëtor, ndërsa në gjuhën Shqipe kërkohen 15 punëtor. Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj deklaratë të mesatares së fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik dhe numrin mesatarë të stafit menaxherial për secilin nga 3 vitet, por assesi të kërkoj numër të caktuar të punëtorëve. Përveç

kësaj Autoriteti kontraktues do të sigurohet që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi të kontratës, përmbajnë informata materialisht identike

Në Njoftim për Kontratë në gjuhën Serbe dhe atë Angleze nuk janë kërkuar fare mjetet, stabilimentet ose pajisje teknike për realizimin e punimeve, derisa të njëjtat mjete janë kërkuar në gjuhën Shqipe. Po ashtu në gjuhën Serbe dhe Angleze, Operatorëve Ekonomik iu është kërkuar plani dinamik për realizimin e projektit 2015-2017, derisa në gjuhën shqipe një kërkesë e tillë nuk ekziston. Kur një autoritet kontraktues synon që të ndërmarrë prokurimin duke përdorur procedura të hapura, të kufizuara ose të negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues do të përgatisë një njoftim të kontratës në gjuhët e caktuara. Autoriteti kontraktues do të sigurojë, që versionet në të gjitha gjuhët të një njoftimi të kontratës, janë në përputhshmëri me ligjin e Prokurimit Publik dhe duhet të përmbajnë informata materialisht identike.

Gjatë analizimit të Dosjes së Tenderit, Agjencia Kundër Korrupsion ka konstatuar se gjatë përpilimit të Dosjes së Tenderit Autoriteti Kontraktues nuk i ka specifikuar mirë kërkesat ose formulimi i tillë le hapësirë për tu mos interpretuar vetëm në një mënyrë. Në Njoftim për Kontratë, pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, Autoriteti Kontraktues, mes tjerash ka kërkuar: Mjete të tjera të punës në baze të specifikave të projektit. Me këtë kërkesë, Autoriteti Kontraktues vetëm se mund të shkaktoj konfuzion tek Operatorët Ekonomik, pasi nuk është kërkuar diçka specifike.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi; Nenin 27 Dosja e Tenderit si dhe Nenin 40 Njoftimi i Kontratës të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; Pikën 23, Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik si dhe Gjendja Ekonomike dhe Financiare i UA-02/2014..

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues anulimin e këtij aktiviteti të prokurimi. Në rast të Ri Tenderimit, të përpilohet Dosja në mënyrë më të përshtatshme duke u bazuar në rekomandimet që dalin nga ky Opinion i Agjencisë, për të mos i lënë hapësirë tendencave manipuluese nga Operatorët Ekonomik.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !